

FJALA E DEPUTETIT AGRON GJEKMARKAJ

E HËNË 20 DHJETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Personalisht nuk e kam mësuar ende gjuhën e politikës dhe të këtij parlamenti, megjithëse zotin Braçe e kuptova, por ai nuk është në modë, me sa shoh, nuk kuptohet nga të tjerët. Meqenëse padija nuk është argument dhe vuajtja më e madhe e njerzimit ka qenë përpjekja për të folur, qysh në kohën e dhëmbëve të Kadmosit, prej nga dolën shkronjat, po leçitem me gjuhën time që krejt memec të mos ngjaj në këtë sallë. Po kaq e madhe është droja se ndonjë ishmiqe në këtë sallë nga krahu i qeverisë, e cila nga mot m'i ka bërë betë e më ka marrë zët se udhëheqësin e dashur i kam lënduar, mos lebetitet me dënësë nga duhma e injorancës. Nuk mund t'ia bëj këtë atentat dijes. Përpiqem ta mësoj gjuhën e re, që të nxë nga fjalimet e liderit global, i cili për ne është si një xhaxha i kthyer nga mërgimi, që të kënaq shpirtin më shakatë e tij plot shejtanllëk, si nektar i jetës dhe kripë e tabanit popullor, e herë tjetër si gozhdë, që ngulen në qivurin e mërzisë shoqërore, për të sjellë shkundullimat e gazit dhe haresë mes nesh, pas çdo pleudarie! Mbaj shënime kur disa ministra, që i kam fort për zemër, flasin aq me mall shtampë, kulturë e thagmë, aq ëmbël, aq butë, me aq melankoli kur shpjegojnë historinë e inceneratorëve, milionat e eurove publike, që i ha dreqi e barku, ky kodosh i pangopur, si dhe mërzinë që SPAK-u shkaktoi në shpirtrat e trazuar nga zhurma e mallkuar prangash noprane. Njerëzit mendojnë që të vjedhësh shkon në ferr, por kjo nuk është e vërtetë! Ngjitesh lart në parajsë qeveritare! Ndaj, kush do të bëjë përpjetë, të rrasë duart poshtë! Shfaqen në sytë e mi të përsheptshëm, si klerikë të moralit, me "r" – të lëmuar nga melhemi njerëzor, aq dhimbshëm për dertet e këtij qerrata vatani, sa gugatje vaji më mblidhen si katakomb në fyt. Fjalët: "betejë për", "guxim në", "krenari kur", "vendosmëri qysh", "në kuadër të", "qytetar si", "rritje ekonomike nga", "për herë të parë në", "në raport me", "vizion i qartë pse", "rrjetëzim i", "vlerë e shtuar", "besueshmëri ndaj", "sepse", "ndonëse", "përse" i kam mësuar pa mundim nga këta mësues të së folurës politike, të qelibarllëkut dhe hyzmeqarllëkut të parasë publike. Gjuha ime si malësor i Lezhës, në anë të detit, shfaq mërzinë se nuk mirëpritet në këtë sallë, por brenda ka shpresën që jashtë saj edhe mund të kuptohet disi. Kur flitet për buxhetin e një vendi shumë të varfër me administratorë, paturpësisht të mirëqenë, të rrjedhshëm në mediokritet, me fytyrën shollë këpuce, që as nuk skuqet, as nuk zverdhet, bëjnë propagandë me shpejtësinë që gatuhet një tasqebap morti.

Sapo mora misionin që të flas sot, vendosa të hulumtoj mbi buxhetin, të cilin Presidenti Meta nuk bëri aspak gabim që e ktheu, sepse të varfrit shtohen dhe shpenzimet për ta bien, ndërsa gënjeshtat rriten. Po kaq dendur përsëritet këshilla për njerëzit: "Mos u bëni qaramanë, o të varfër, se mirë jeni! Mos u bëni teveqelë, po thirrini mendjes, kaq boll e kini". Dua të ndalem pak te rreziqet serioze që rrethojnë pritshmëritë e parashikuara në ligjin e buxhetit të shtetit për vitin 2022 në mënyrë antropologjike. Rritja ekonomike me mbi 4,5% në vit dhe në kushtet e një stabiliteti makroekonomik, e cila ka qenë tipike për pothuajse gjithë periudhën e tranzicionit, mendoj se do të jenë të kërcënuara nga të paktën dy zhvillime. Së pari, pandemia Covid-19 duket se akoma është larg të vendosurit nën një kontroll të plotë! Virusi nuk i dëgjon të luturat e qortimet e ministres së gëzimit shëndetësor, që çdo ditë u thotë: "Ush or dreq, ik këndej", fakt që do të ketë ndikime në rikthimin e normalitetit të jetës ekonomike e sociale në vend. Siç po provohet edhe tani, industrinë e udhëtimeve e turizmit dhe të disa lloje shërbimesh duket se do të vazhdojnë të përjetojnë goditje negative, edhe pse ministrja e pastërtisë kundër pislëkut, shfaqet duke pastruar letra e ndukur barishte sokakëve. Propozoj që edhe

ne si deputetë të zapsim barin para parlamentit, të lyejmë pemët, ndërsa zonjat të hekurosin perdet, si dobi publike dhe mesazh etik.

Së dyti, ndikimet afatgjata në shoqërinë paspandemike kanë filluar të manifestohen në ekonomi, duke dhënë efekte të forta dhe të dukshme. Ndërprerjet në zinxhirin global të furnizimit, megjithëse vetë zoti Ahmetaj shkoi si Dhaskal Todri në Alemanjë me dy tre mushq e gomarë për të blerë zahire, ishin ndër shkaktarët kryesorë të rritjes së çmimeve të mallrave, duke ushtruar presione të forta mbi të ardhurat reale të qytetarëve, veçanërisht të familjeve me të ardhura modeste. Nga ana tjetër, rritja e çmimeve të produkteve energjetike të diktuar nga faktorë kompleks, por, mbi të gjitha, nga keqmenaxhimi dhe ca vese të njohura, janë të dukshme. Disa lidhen edhe me tranzicionin energjetik, në të cilin ka hyrë njerëzimi për shkak të respektimit të detyrimeve për mbajtjen në kontroll të efekteve negative të klimës. Ato kanë shkaktuar pasoja negative në ekonomi në tërësi, megjithëse ministrja e hesapeve publike, bashkë me atë të kalamajve, i kanë shkruar një letër baba diellit që të mos na përcëllojë dhe stinëve të na sjellin shi, ndërsa OSHEE-së të mos luaj pisët në treg. Fenomeni i inflacionit, i cili prej kohësh nuk kishte qenë në vëmendjen e publikut dhe politikëbërjes, tani është shfaqur si shqetësim serioz për hir të pasojave të forta që mund të sjellin në ekonomi. Një rritje e normave të interesave për të frenuar inflacionin, sipas detyrimeve ligjore që kanë bankat qendrore, do të rriste ndjeshëm koston e borxhit publik, i cili, në nivelet e sotme, gjykoj se e ka kaluar vijën e kuqe. Kësisoj qeveria është e detyruar të tërhiqet nga politikat agresive buxhetore për shkak se hapësirat fiskale janë tejkaluar prej kohësh.

Në planin social, rritja e inflacionit po gërryen përditë të ardhurat reale dhe fuqinë blerëse të familjeve. Dje, ministri Bledi Çuçi, megjithëse kishte uri ujku, nuk kishte para për byrek! Piu vetëm një gotë bozë dhe gjithë ditën e mbytën gromësimat! Nëse nuk do të ndërmerren politika kompensuese të të ardhurave, fenomeni i varfërisë, që edhe kështu është i lartë, mund të përkeqësohet e më tej. Qeveria vitin tjetër do t'i blejë palltot te rrobat e përdorura, ndaj hijeshia e tyre mund të pësojë goditje dhe ëndja jonë për t'i këqyrur, bie në depresion! Së fundi, akoma nuk kemi një agjendë të qartë të veprimeve të qeverisë për reformat që do të ndërmerren, në mënyrë që të stimulohen investimet private. Për shembull, Niko do të blejë libra me gjëgjëza dhe s'ka lekë, qeveria do të pësojë shok në erudicion. Klima e biznesit dhe konkurrueshmëria e ekonomisë mbeten të dobëta dhe nuk japin ndonjë shpresë për një "goditje" të fortë pozitive në sektorin real të ekonomisë. Për arsimin e kulturën ç'të them, asgjësend, veç fjalë, fjalë, që janë bërë mullar! Rrogat e pedagogë e të mësuesve janë aty ku janë, nuk ka asnjë rritje, s'ka asnjë investim në teknologji, por ka vetëm fjalë. Edhe për rrogat e policëve, të cilët ankohen, nuk ka asgjë. Për pensionet po njësoj, megjithëse pensionistëve nuk kanë ç'u duhen lekët, pasi rrinë në shtëpi. Në fund, kam një kërkesë për ministren Balluku. Një përfaqësi e Torovicës së Lezhës kërkon një takim me ju, zonja Ministre, pasi nuk kanë ujë të pijshëm dhe duan një ujësjellës sa për të njomur buzët! Ju lutem, pritini, kur të keni kohë! Faleminderit!